



VENDIM

Nr. 1, Datë 27.01.2016

MBI

**KUNDËRSHTIMIN E VENDIMIT TË ERE NR. 156 DATË 24.12.2015
“MBI LENIEN NE FUQI TE VENDIMEVE NR .139, NR. 140, NR 141, NR.
145, NR. 146, NR. 147, NR. 148 DATE 26.12.2014 SI DHE TË VENDIMIT
NR. 27 DATE 16.02.2015 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE PËR
PERIUDHËN 1 JANAR 2016 – 30 QERSHOR 2016”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 pika 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.01.2016, mbasi shqyrtoi kundërshtimin e shoqatës AREA dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike në lidhje me vendimin nr. 156, datë 24.12.2015 “Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr .139, nr. 140, nr 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148 datë 26.12.2014 si dhe të vendimit nr. 27 date 16.02.2015 të Bordit të Komisionerëve të ERE për periudhën 1 janar 2016 – 30 qershor 2016”,

Konstatoi se:

1. Vendimi nr. 156, datë 24.12.2015 i Bordit të ERE i bazuar në VKM nr. 125, datë 11.02.2015 “Për miratimin e metodologjisë të përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, për vitin 2015, që do t’i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 237 -2015 si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE.
2. VKM nr.125, date 11.02.2015 ‘Për miratimin e metodologjisë të përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, për vitin 2015, që do t’i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet’ ka përcaktuar metodologjinë e

përcaktimit të tarifave fikse të energjisë për vitin 2015 nga kjo kategori prodhuesish.

3. Vendimi nr 1033 datë 16.12.2015 i Këshillit të Ministrave (botuar ne fletoren Zyrtare nr 221-2015), në nenin 2, sanksionon të drejtën e ERE për marrjen e masave në përcaktimin e një çmimi që do të aplikohet për një periudhë të ndërmjetme, në zbatim të vendimit nr. 125, datë 11.2.2015, të Këshillit të Ministrave.
4. Vendimi Nr 1033 Datë 16.12.2015 i Këshillit të Ministrave ka parashikuar në nenin 3 të tij se “Pas publikimit të raportit vjetor (Physical futures Annual report) nga bursa e Hungarisë HUPX, për vitin përkatës, siç përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015 ERE do të shprehet me vendim “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2016, prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”
5. Subjekti ankues mbështet kundërshtimit e tij në paligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 125, datë 11.02.02015.
6. Ligji nr. 138/2013 “Për burimet e rinovueshme” në nenin 15 pika 3 përcakton se, ERE, në përputhje me metodologjinë e hartuar për tarifën fikse, çdo fund viti, miraton vlerat përkatëse të tarifave fikse, që duhet të paguhet për prodhuesit me përparësi.
7. Baza ligjore për paraqitjen e këtij ankimi mungon, dhe është e paqartë nëse subjekti që ka parashtruar kundërshtimin, kërkon me të rishikimin e vendimit apo shfuqizimin e tij.
8. Kërkesa për rishikim vendimi, referuar Nenit 16 pika 5 të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe Nenit 16 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE” mund të kryehet nëse janë siguruar apo disponohen prova të reja, që mund ta çojnë Bordin të marrë një vendim të ndryshëm.
9. Nuk konstatohet të jetë paraqitur asnjë provë e re që të çojë Bordin e ERE në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga vendimi objekt kundërshtimi.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqatës AREA për kundërshtimin e vendimit të ERE nr. 156, datë 24.12.2015 “Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 140, nr 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014 si dhe të vendimit nr. 27, datë 16.02.2015 të Bordit të Komisionerëve të ERE për periudhën 1 janar 2016 – 30 Qershor 2016”
2. Drejtoria Juridike dhe e mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit AHMETI